Kuvendit janë shfaqur mangësi dhe dobësi në organizimin e seancave dëgjimore. Këto seanca nuk kanë qenë të organizuara sipas një procedure të caktuar. Janë shfaqur probleme etike në mënyrën e të komunikuarit ndërmjet anëtarëve të komisionit hetimor dhe personit të thirrur për të dëshmuar, zakonisht kur kanë qenë përfaqësues të forcave politike kundërshtare. Kjo është shoqëruar dhe me politizim të seancës dëgjimore, sidomos kur janë ftuar për të dëshmuar aktorë të rëndësishëm politikë dhe, për rrjedhojë, kjo ka ulur efektivitetin dhe ka cënuar objektivitetin e hetimit parlamentar. Seancat dëgjimore kanë qenë të hapura për median, ku ka patur pretendime dhe për raste të shkeljes së sekretit shtetëror.⁸

Gjatë hetimeve të fundit parlamentare për “Për shqyrtimin e

⁸ Pretendime janë ngritur në media për shkelje të sekretit shtetëror gjatë zhvillimit të hetimit parlamentar për veprimtarinë e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të ishdrejtuesit të këtij institucioni z.Fatos Klosi, i ngritur me vendimin e Kuvendit nr.52, date 31.07.2002.

lowed to offend or insult the dignity of the persons who are summonsed by the committee.⁷

During the inquiries conducted by the Assembly, weakness in the organization of hearing sessions have been manifested. These sessions have not been held according to a given procedure. Ethical problems have been identified with regard to the manner of communication among the members of the inquiry commission and the persons summonsed to testify, most commonly when the latter have been representatives of opposing political forces. This has been accompanied with the politicization of the hearing sessions, particularly when major political actors have been invited to testify and this has therefore led to lesser effectiveness and objectivity in the parliamentary inquiry. The hearing sessions have been open to the media and allegations for violations of the state secret have been made.⁸

⁷ Idem, Article 12.

⁸ Allegations have been published in the media about violations of state secret during parliamentary inquiries into the activity of

transparencës së fajdeve”⁹ dhe për Telekomunikacionet¹⁰ ka një përpjekje pozitive përse i përket formatit të organizimit të seancave dëgjimore dhe etikës së komunikimit gjatë zhvillimit të këtyre seancave.

SEANCAT DËGJIMORE NË ZONËN ZGJEDHORE

Në ligjin për “Statusin e Deputetit” parashikohet se deputeti u merr mendime zgjedhësve për projektligje, amendamente, vendime dhe materiale të tjera që shqyrton Kuvendi.¹¹ Seancat dëgjimore me grupe të veçanta në zonën zgjedhore do të ishin një nga format për realizmin e këtyre detyrimeve që lidhen me rolin përfaqësues të deputetit.

⁹ Komisioni hetimor Parlamentar i ngritur me vendimin e Kuvendit nr.72, datë 17.03.2003.

¹⁰ Komisioni hetimor Parlamentar i ngritur me vendimin e Kuvendit nr.121, datë 19.02.2004.

¹¹ Neni 5 i ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i Deputetit”.

During the latest parliamentary inquiries into the “Money-lending pyramid schemes”⁹ and Telecommunications¹⁰, positive efforts have been made regarding the format of the organization of the hearing sessions and the ethics of communication during such hearings.

HEARING SESSIONS IN THE CONSTITUENCIES

The law on the “Status of deputies” envisions that the deputies receive the opinions of their voters about bills, amendments, decisions and other documents that shall be examined by the Assembly.¹¹ Holding hearing sessions with individual

the State Information Service and the former director of this institution Mr. Fatos Klosi, established in the decision no. 52 of the Assembly, dated 31 July 2002.

⁹ Parliamentary Inquiry Committee set up in decision no. 72 of the Assembly, dated 17 March 2003.

¹⁰ Parliamentary Inquiry Commission set up in decision no. 121 of the Assembly, dated 19 February 2004.

¹¹ Article 5 of Law no. 8550, dated 18 November 1999 “On the status of deputies”.

Nga monitorimi i kryer nga QSP-ja nuk rezulton që seancat dëgjimore, sipas informacionit të disponueshëm, përdoren nga deputetët në zonat zgjedhore për të marrë opinionin e zgjedhësve lidhur me projektligje dhe çështje të tjera që janë për shqyrtim në Kuvend.

groups in the electoral zone is one of the ways for realizing the obligations linked with the representative role of the deputy.

The survey conducted by the CPS shows that the members do not use hearing sessions as one of the tools to get the opinions of the voters about the bills and about other questions under consideration in the Assembly.

Viktor GUMI – LLM
Drejtor i Departamentit të
Çështjeve Ligjore dhe Kushtetuese

Head of the Department on
Constitutional and Legal Issue
Albanian Parliament

Lobimi Parlamentar

Tradicionalisht koncepti i “lobimit” kuptohet si një proces i tërë komunikimi, me anë të të cilit përfaqësues të grupeve të interesit përpiqen të ndikojnë tek autoritetet vendimmarrëse shtetërore për të miratuar preferencat e tyre politike.¹ Ky koncept në kohët e sotme është zgjeruar së tepërmi dhe ka arritur në atë shkallë, sa të përfshijë jo vetëm nivelet politikëbërëse në nivel kombëtare, por edhe ato në nivel vendor, rajonal ose agjenci të ndryshme jashtëqeveritare².

Në ndryshim thelbësor me ndonjë perceptim popullor, sipas së cilit lobimi mund të etiketohet si dukuri

Parliamentary Lobbying

Traditionally “lobbying” refers to process that is understood as a set of communication channels that interest groups use to try to influence decision makers¹. This concept currently has been extended to include not only national but also local and regional decision making structures outside National Government².

Despite some popular perceptions that view lobbying as a corruptive activity, in practice lobbying is quite the opposite. This due to the fact that 1) lobbying could become a very transparent activity

¹ L.W. Milbrath, Lobbying, 1968, f. 442

² M.P. van Schendelen, (ed.), National Public and Private EC Lobbying, Dartmouth, 1993

¹ L.W. Milbrath, Lobbying, 1968, f.442

² M.P. van Schendelen, (ed.), National Public and Private EC Lobbying, Dartmouth, 1993

“korrupsioni” ose “klane klienteliste”, ai në të vërtetë është krejt e kundërta. Kjo sepse 1) lobimi si veprimtari mund të bëhet përherë e më tepër transparente nëpërmjet formave të regjistrimit dhe kontrollit financiar ndaj tij; 2) lobimi mbështetet mbi profesionalizëm, që do të thotë se ai kërkon domosdoshmërisht disa individë dhe zyra, brenda grupimeve të caktuara të interesit, të specializuara në monitorimin e procesit legjislativ, në mbledhjen e një informacioni të specializuar për nevojat dhe interesat e tyre dhe ofrimi i këtyre të fundit tek autoritetet vendimmarrëse shtetërore dhe 3) veprimtaria lobiste mund të transferohet për t’u kryer në ente të posaçme për këtë shërbim. Për pasojë, lobimi nuk mbështet as në marrëdhënie vetjake, as në marrëdhënie ndërvartësie dhe as nuk e vendos autoritetin vendimmarrës para një situatë në të cilën konfliktohet interesi privat me atë publik.

PËRQASJE TEORIKE PËR LOBIMIN

Sipas teorive pluraliste, imazhi pluralist i interesave politikë presupozon se grupimet e interesit apo shtresa

if properly registered and supervised financially 20 lobbying requires expertise and therefore individuals are dominated by the offices that gather information and monitor the legislative process providing thus more transparency for the public at large 3) lobbying can be performed thus by specialized units and agencies that can be supervised. Therefore, lobbying is not necessarily reduced to personal relationships, neither does it place the legislation in a subordinated position or produce conflicts of interests between the private and the public domain.

ATHEORETICAL APPROACH TO LOBBYING

According to pluralist theories in a plural society different interest groups with a variety of backgrounds and interests should have equal opportunities to be organized and influence decision making. Those who were critical about such views focused on the partiality of such presumptions. Criticisms could be organized into to groups; either

shoqërore të madhësive të ndryshme dhe me origjinë sociale të larmishme kanë mundësi pothuajse të barabarta për t'u organizuar dhe për të ndikuar në proceset vendimmarrëse. Kritikata e këtyre teorive u fokusuan në pamjaftueshmërinë e këtyre prezumimeve. Këto kritika përmbledheshin ose në rrafshin teorik³, ose në kushtet empirike të një situate tipike joamerikane.⁴ Në "luftën" mes argumenteve dhe kundërgjendimeve, në Europë vazhdoi të mbizotërojë teoria neopluraliste, e cila mbrojtë idenë klasike konstitucionaliste të një qeverisjeje parlamentare si një mekanizëm integruar, duke u përpjekur në të njëjtën kohë ta përshtasë atë me natyrën moderne të interesave në shoqëri. Nga një këndvështrim i tillë, roli mbrojtës i parlamentit ndaj interesit publik u konsiderua se ishte i përputhshëm edhe me ekzistencën e grupimeve të

purely on theoretical grounds³ or on empirical ones that would refer to cases very different from the US scenario⁴. In Europe the clash between different views is dominated by the neo-pluralist perspective, which is based on the traditional constitutionalist perspective in which parliamentary government is the crucial integrative mechanism, while at the same time trying to adopt this view to modern realities. Such view holds that the role of the Parliament as the main guarantor of public interests is compatible with the existence of interest groups that are organized not only around personal and local interest as it used to be the case during the classical liberal period. Furthermore, in Western Europe parliamentary practices developed a

³ M. Olson, *The Logic of Collective Action: Goods and the Theory of Groups*, Cambridge: Harvard University Press, 1965

⁴ J. La Palombara, *The Utility and Limitations of Interest Groups Theory in non-American Field Situations*, në *Journal of Politics*, nr. 22, 1960

³ M. Olson, *The logic of Collective Action: Goods and the Theory of Groups*, Cambridge: Harvard University Press, 1965

⁴ J. La Palombara, *The Utility and Limitations of Interests Groups Theory in non-American Field Situations*, *Journal of Politics*, no.22,1960

fuqishme të interesit dhe jo vetëm me interesa vetjake e vendore si në kohën e parlamentarizmit klasik liberal. Për më tepër, parlamentarizmi në Europën Perëndimore në rrjedhën e viteve, me qëllim përballjen me shkallën e rritjes së organizimit të interesave, u pajis edhe me “mjete” të tjera duke filluar që me rregulla kushtetuese dhe procedurale, deri në procedura formale të krijuara për të institucionalizuar dhe kontrolluar ato. Paraqitja dhe zhvillimi i një arsenali të tillë mund t’i atribuohet një numri faktorësh teorikë.

1. *Teoria statiste konservative* fokusohet në rrezikun e unitetit të shtetit nga një pluralizëm i interesave të veçantë.⁵ Në këtë vështrim, një autonomi relative e institucioneve shtetërore *vis a vis* interesave të veçantë privatë mund të arrihet vetëm duke kufizuar ose përjashtuar rreptësisht interesat privatë në arenën parlamentare. Shembuj të tillë janë: ndalimi i mandatit imperativ, papajtueshmëritë në ushtrimin e

series of institutions, procedures and other mechanisms to deal with growing interest groups and their organization so as to better oversee them. Such development can be attributed to a variety of factors at least theoretically.

1. *The Conservative Estatist Theory*, which focuses on the threat that pluralist particular interest groups present to the state unity⁵. Therefore, the only way to endow state institutions with a certain degree of autonomy is to exclude interest groups from parliamentary practices. There are many such examples in current parliamentary restrictions, such as the incompatibility of certain functions, the obligation not to participate in debates where personal interests are involved, the restrictions for Parliamentarians to participate in economic and social activities.

2. *The Party Democracy Perspective* sustains that the

⁵ Për me teper në lidhje me kete teori C. Schmitt, “Pluralismus als Theorie der Auflosung des Staates” në F. Nuscheler dhe W. Stefafani (eds.) *Pluralismus*, 1972

⁵ For more information regarding this theory C. Schmitt, “Pluralismus als Theorie der Auflosung des Staates” in F. Nuscheler and W. Stefafani (eds.) *Pluralismus*, 1972

funksioneve dhe në pjesëmarrjen e anëtarëve të parlamentit në sferën ekonomike dhe sociale, regjistrimi i interesave privatë të deputetëve dhe kufizim i pjesëmarrjes së deputetëve në proceset e diskutimit dhe vendimmarrjes për çështje që prekin drejtpërdrejt interesa të tyre vetjake.

2. Në *perspektivën e demokracisë partiake*, lidhja e parlamentit me grupime të interesit kryhet nga partitë dhe grupet parlamentarë të cilat funksionojnë si ruajtës ose filtra dhe përmbledhëse të kompleksitetit të interesave të veçantë ose të grupimeve të ndryshme. Struktura dhe procedura të krijuara për këtë qëllim janë disiplinuar partiake, dominimi i grupimeve parlamentare në procesin ligjvënës ose funksionimi brenda partive parlamentare i organeve partiake që mbajnë lidhje të ngushta me grupime shoqërore. Ndërsa lidhje të tilla të forta mes partisë dhe grupimeve të interesit të krijojnë në një anë përshtypjen se partia është shprehje e fshehur e grupeve të tilla, nga ana tjetër, sa më forta të jenë lidhjet, aq më tepër forcohet roli i tyre si *gate keepers* dhe sa më tepër shtohen radhët e anëtarësisë së partisë, aq më e madhe është larmia e interesave që do të

connection between Parliament and interest groups is safeguarded through political parties which serve to filter and aggregate individual or group interests. A variety of structures and mechanisms have been developed to this end such as disciplined parliamentary groups especially with regard to legislation, the oversights of political parties over party officials or party mechanisms within parliamentary groups that serve to connect them to different social groups. Despite the appearance of political parties as a refuge for hidden interests, the fact of the matter is that the stronger the connection of they party with interest groups the more the former serves as a *gate keeper* for the latter and the larger the party membership the larger the variety of interests that it manages and satisfies.

3. *According to the Neo-Corporatist Approach the* weakening of the party – Parliament relationship has produced a stronger legislative branch capable of better overseeing the executive especially as indicated by the increasing number of

mbrojë ajo parti.

3. *Sipas teorisë neokorporatiste*, rënia e nivelit të marrëdhënieve parti - parlament është shoqëruar me efektin e forcimit të rolit të parlamentit ndaj ekzekutivit, veçanërisht në fushën e komisioneve të parlamentit.⁶ Një nga funksionet më të rëndësishme të komisioneve parlamentare në shumë vende të Europës Perëndimore, duke filluar qysh në vitet '80, ka qenë ai i së drejtës për të mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësues të grupimeve të ndryshme sociale të shoqërisë. Një praktikë e tillë jo vetëm që forcon pozicionin e parlamentit përballë monopolit të informacionit që e marrin dhe mbajnë institucionet e ekzekutivit, por në mënyrë të dukshme siguron transparencën e influencës së interesave të grupimeve të ndryshme shoqërore në procesin legjislativ.

FORMA TË LOBIMIT: NJË VLERËSIM EMPIRIK DHE KRAHASIMI I TIJ ME REALITETIN SHQIPTAR

Në ndryshim me situatën në Shtetet

parliamentary commissions⁶. Ever since the '80-s the one of the main functions of parliaments in Western Europe has been to hold hearings with different social groups. Such practice not only strengthens the legislative process but also provides Parliament with an important information-gathering instrument that frees it from the informative monopoly of the executive branch. This also produces more transparency in decision making.

APPROACHES TO LOBBYING: AN EMPIRICAL ASSESSMENT AGAINST THE ALBANIAN REALITY

Unlike in the USA where interest groups are easily identifiable and registered in Europe they are less visible and function through a more hidden network which operates almost informally. The absence of reliable data and information makes any comparisons difficult although

⁶ G.Lembruch dhe P.C. Scmitter, Patterns of Corporatist Policy Making, 1982

⁶ G. Lembruch and P.C. Scmitter, Patterns of Corporatist Policy Making, 1982

e Bashkuara të Amerikës, ku grupet lobiste në legjislaturat e shteteve mund të identifikohen lehtë, sepse janë të regjistruara zyrtarisht, në Europë marrëdhëniet e parlamentit me interesat e organizuar shpesh paraqiten nëpërmjet rrjetash të fshehura ose të paktën në mënyrë joformale. Mungesa e të dhënave e bën detyrën e klasifikimit të formave të lobimit edhe më të vështirë në kontekstin europian, i cili, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, dallohet qartësisht nga ai i zhvilluar në Amerikën Veriore. Karakteristika europiane në përfaqjen ndaj lobimit është përqendruar më tepër në vendosjen e rregullave ligjore për kufizimin e pasojave negative të dukurisë në vetvete. Nëpërmjet procedurash parlamentare janë përcaktuar masa dhe praktika, të cilat kanë synuar të “displinojnë” dhe “balancojnë” ndikimet dhe interesat privatë në procesin e bërjes së legjislatcionit.

a) Papajtueshmëritë ekonomike me mandatin e deputetit

Në Europë kushtetutat e çdo vendi përgjithësisht e ndalojnë mandatin imperativ por, përsa i përket çështjeve

lobbying in Europe is fundamentally different both in terms of process and content from that developed in North America. It is characteristic of the European approach to focus on regulations that aim to limit the negative externalities of lobbying. Parliamentary procedures are devised so as to discipline and balance private interests in the decision making process.

a) Economic Incapability of the Members of Parliament

European experiences, despite some commonalities, vary to a great degree in this regard since they reflect the historical experience and social conditions of each country. In most cases incompatibility is defined against the principle of the separation of powers, which stipulates that the same person cannot hold a public and a legislative one at the same time. In Austria a deputy that has a position in a commercial or business enterprise has to declare his position and salary with the parliament. A special commission decides then whether there is an incompatibility

të papajtueshmërisë dhe përputhshmërisë me detyrën e deputetit, përvojat europiane ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Në shumë vende rastet e papajtueshmërisë rrjedhin drejtpërdrejt nga parimi i ndarjes së pushteteve përsa i përket postit publik dhe mandatit parlamentar. Në Austri, deputeti, i cili mban një pozicion drejtues në një shoqëri tregtare ose kompani sigurimesh, ose në sektorë të tjerë si ato bankare, industriale ose tregtare, duhet të bëjë publik pozicionin e tij, si dhe pagën mujore të kryetari i dhomës në të cilën ai është anëtar. Komisioni për papajtueshmërinë vendos nëse ka raste të papajtueshmërisë me detyrën e deputetit ose jo. Në Asambleenë Kombëtare Franceze një numër i madh ligjesh, pas 1875-ës, atëherë ku veprimtaritë shtetërore ekonomike morrën jetë, përcaktojnë rastet e papajtueshmërisë së deputetit dhe një sërë funksionesh në rang shoqërorish ose korporatash, të cilat ose përfitojnë nga fondet shtetërore, ose kryejnë funksione ekzekutive në emër të shtetit. Më tej deputeti nuk mund të shërbejë as edhe si këshilltar për këto shoqëri dhe sanksionet për shkelje nga ana e deputetëve përcaktohen në një ligj të

between his/her two positions. In the French National Assembly, especially after 1875 when the economic boom began, a great number of laws and regulations stipulate in detail the cases of incompatibility between the position of deputy and other positions in the private sector. Furthermore, in the case of France the deputy cannot even serve as a consultant to companies that have contracts with the Government, otherwise there are strict sanctions that are outlined in a separate law.

In the Greek Constitution the position of deputy is incompatible with that of a board member, director or employee in a private enterprise that are funded by the State. In the same fashion in Italy it has been clearly stipulated in the law that the position of the deputy is incompatible with private functions such as being involved in private companies that have governmental contracts. More specifically deputies cannot be administrators, directors, board members and legal consultants to enterprises that have transactions

veçantë. Kushtetuta greke përcakton se detyra e një deputeti është e papajtueshme me veprimtarinë e një anëtarë bordi, drejtori të përgjithshëm ose një të punësuar në shoqëri ose ente tregtare, të cilat kanë disa privilegje të caktuara nga shteti ose marrin subvencionime prej tij. Në Itali është përcaktuar me ligj të veçantë se biznesmenë privatë ose përfaqësues ligjorë të enteve private, të cilët janë të lidhur me shtetin nëpërmjet kontratave dhe koncesioneve nuk mund të ushtrjnë edhe detyrën e deputetit në të njëjtën kohë. Anëtarët e parlamentarit nuk mund të kenë detyra të tilla si ajo e administratorit, presidentit, drejtorit të përgjithshëm ose një këshilltari ligjor të përhershëm në shoqëri me funksione publike në të cilat shteti kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Detyrime të tilla janë edhe për kompani me veprimtari financiare në bursë etj. Deputetet nuk lejohen të këshillojnë ndërmarrje apo shoqëri në veprimtari të dhe transaksionet financiare që këto bëjnë me shtetin.

* * *

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 70 të saj përcakton

with the State.

The Albanian Constitution in Article 70 stipulates that the position of deputy is compatible only with that of the member of the Council of Ministers, which means that the deputy cannot perform any other state functions. Other more specific cases are determined with a special law. The law that should satisfy this need should be the law "On the Status of the Deputy", which although was approved in 1999, i.e. after the ratification of the Constitution, is almost the same as the law of 1991. The only additional restriction that this law provides is in point 3 of article 3, where it states that the deputy cannot be director or member of a private enterprise. It is easy to argue that such provision is unconstitutional since the cases of incompatibility in the case of the deputy cannot and should not be the same as in the case of the member of the Council of Ministers. The rationale in the constitutional provisions has been that the two positions, deputy and Member of the Council of Ministers, are of a very

se detyra e deputetit është e pajtueshme vetëm me atë të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Për pasojë deputeti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër shtetëror. Rastet e tjera të papajtueshmërisë Kushtetuta lejon të përcaktohen me ligj të veçantë. Natyrisht që ligji që duhet t'i përcaktojë ato duhet të jetë ligji "Për statusin e deputetit", i cili pavarësisht se është miratuar më 18.11.1999, pra pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, në shumë drejtime ngelet i njëjtë, madje me të njëjtat formulime që ka pasur ligji nr.7503, datë 27.7.1991 "Për statusin e deputetit në Kuvendin Popullor". I vetmi rast shtesë që parashikon ky ligj për papajtueshmërinë me detyrën e deputetit është ajo e të qenit drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurese (*neni 3 pika 3*). Sikundër edhe mund të vlerësohet lehtë, ky formulim mund të atakohet si në përmbajtje, që bie ndesh me Kushtetutën dhe kjo sepse rastet e papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës nuk mund dhe as nuk duhet të jenë të njëjta me ato të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Ideja e ligjvënësit në Kushtetutë ka qenë se, duke qenë realitete të ndryshme ato duhet të kenë

different nature, and as such they require different legal provisions to define incompatibility. Otherwise in the Constitution they would be grouped under the same constitutional provision. In practice it is impossible to deny to the deputy the position of a director in a private enterprise. An analyses of the above mentioned law would indicate that it has to be reformulated from scratch in based on the principle that the status of the deputy entails not only privileges but also responsibilities. A reformulation could reflect some of the best western experiences in this field compatible with the Albanian conditions.

The Albanian Constitution also prohibits any involvements of the deputy in making profit from state assets both at the central and local governments (article 70 point 2). This provision is similar with that in the Greek Constitution. The reason which such provision has become Constitutional reflects the importance that such prohibition has for Albania. However, although the Constitutional principle is very clear, there are no

edhe rregullime juridike të ndryshme, përndryshe ai në Kushtetutë do t'i gruptonte ato në një dispozitë të vetme. Në planin praktik nuk mund t'i mohohet deputetit qenia e tij si drejtues i një shoqërie fitimprurëse, domethënë pronar i një biznesi privat. Nëse i bëhet ligjit të sipërpërmendur një analizë tërësore, rezulton se ai duhet riformular edhe një herë nga e para, nën këndvështrimin se statusi i deputetit nuk ka vetëm privilegje, por edhe detyrime dhe në përmbajtje ai duhet të reflektojë përvojat më të mira perëndimore dhe ato të Europës Lindore, me kushte të ngjashme me ato shqiptare.

Gjithashtu, Kushtetuta parashikon se deputeti nuk mund të kryejë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre (neni 70 pika 2). Një formulim i tillë është i ngjashëm me atë të bërë në Kushtetutën Greke, dhe arsyeja, se një veprimtari e tillë ka karakter të dëmshëm për shoqërinë shqiptare, e ka ngritur atë në nivelin e normës kushtetuese. Po nëse jepet qartë parimi, legjislacioni shqiptar nuk ka përcaktuar mekanizmat e kontrollit për implementin e këtij parimi. (Ndoshta vendi për këtë gjë do të ishte

instruments in the Albanian legislations in order to implement such provision in practice (perhaps this could be done in the Parliamentary Rules of Procedure or in the Law “On the Status of Deputy”). Otherwise it is impossible for the Speaker of Parliament or one tenth of the members to follow specific cases although according to section 3 of Article 70 they have the right to take incompatibility allegations to the Constitutional Court.

b) The Declaration of Assets and Financial Interests of the Deputy

One of the ways to limit undue private interests in the decision making process by deputies is through the declaration of assets. Procedures, laws and regulations in this regard vary from one country to the other, however it is easy to distinguish four general categories:

1. Countries in which the declaration is public and applies to all decision making categories, as well as countries where the

ose Rregullorja e Kuvendit ose ligji për statusin e deputetit). Është e pamundur që Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e deputetëve të kontrollojë, dhe për më tepër zbulojë, nëse një deputet ka shkelur këtë parim kushtetues ose jo, pavarësisht se ata kanë të drejtën sipas pikës 3 të nenit 70 ta dërgojnë çështjen e papajtueshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.

b) Deklarimi dhe bërja publike e pasurisë dhe e interesave financiare të deputetit

Një nga mënyrat nëpërmjet të cilave kufizohen përpjekjet për të ndikuar në procesin legjislativ nga ana e deputetëve me interes vetjak në një çështje të caktuar ose me “mandat imperativ” në favor të personave të tretë, është dhe vendosja e detyrimit për deklarim të pasurive dhe interesave financiare të tyre. Rreptësia e rregullave ligjore për këtë dukuri dhe forma e tyre variojnë nga një shtet në tjetrin, por katër kategori mund të dallohen qartë:

1. Vendet të tilla si Austria dhe Luksemburgu, ku deklarimi i mësipërm nuk është publik dhe i pakufizuar në kategori të caktuara, ashtu si edhe disa vende ku deklarimi i tyre është publik,

declaration is public but done on voluntary bases such as Denmark and Belgium.

2. Countries like France and Holland, Norway and United Kingdom where the declaration is a long tradition and also obligatory. In Portugal and Spain the declaration is compulsory but not accessible to the public at large.

3. The third category consist of Germany, Italy and the European Parliament where the declaration is extremely detailed, mandatory and open to the public at large. In Italy the declaration of assets was first introduced in 1982 and it requires from the deputy a declaration of his/her assets, expenditure during the electoral campaign, as well as that of the spouse and the primogeniture. In Greece the obligation is applied until three years after the end of the term in office.

4. In the case of Sweden, Finland and Ireland the declaration of assets is done under very scrutinizing regulations. In Finland a deputy can participate in the discussion of an issue where s/he has stakes, but

por kryhet kryesisht mbi baza vullnetare (Belgjike, Danimarkë).

2. Kategoria e dytë ku përfshihen vende të tilla si Franca, Holanda, Norvegjia dhe Mbretëria e Bashkuar, ku deklarimi i mësipërm është traditë e hershme dhe e detyrueshme për t'u bërë. Në Portugali dhe Spanjë deklarimi është i detyrueshëm, por akses i publikut në informacionin që ai mbart është i kufizuar.

3. Kategoria e tretë përmban vende të tilla si Gjermania, Greqia, Italia, Zvicra, si dhe Parlamenti Europian, ku deklarimi i pasurisë është më i detajuar se në çdo vend tjetër, i detyrueshëm dhe publik. Në Itali deklarimi u vendos për herë të parë në 1982, duke u kërkuar deputetëve të deklarojnë jo vetëm pasurinë tyre, por edhe atë të bashkëshortit dhe fëmijëve madhorë, si dhe detyrimet dhe shpenzimet e kryera gjatë fushatës zgjedhore. Në Greqi detyrimi për deklarim jo vetëm që kryhet çdo vit, por ai mbartet edhe për tre vjet pas mbarimit të mandatit.

4. Në rastet e Suedisë, Finlandës dhe Irlandës, deklarimi i pasurisë, pavarësisht nëse është traditë ose i detyrueshëm shoqërohet edhe me rregulla më strikte për procesin ligjberës.

without being able to vote on the issue. In Sweden the procedure excludes even participation in the discussion in such cases. In Britain representatives are required to declare their interests on the issue under discussion, after which they can participate and vote on it.

In Albania the declaration of assets was first regulated by law in 1995, Law No. 7903. However the law was never implemented in practice and the structures that were set up proved to be dysfunctional. Some of the main shortcomings were the large number of subjects that had to declare their assets, the composition of the structure that was to perform oversight, the unclear requirements of the declaration and the lack of competences to apply it properly in practice. All these factors combined meant that in practice people would be fined for not submitting their declarations on time but not on merit of the content of the declaration.

Decision-makers took up the matter again under the pressure of the international factor, although this

Në Finlandë rregullorja e Parlamentit i jep të drejtë çdo deputeti të marrë pjesë në shqyrtimin e një çështje që lidhet me interesat e tij privatë, por të mos marrë pjesë në votim për atë çështje. Rregullorja e Parlamentit Suedez shkon më tej, duke u kërkuar deputetëve në një situatë të tillë të mos marrin pjesë në diskutim dhe votim jo vetëm në seancë plenare, por edhe në komisionet e Parlamentit. Në Britani gjatë zhvillimit të debatit për një çështje, deputeti duhet të deklarojë interesin dhe lidhjen e tij me të, por ai lejohet të marrë pjesë në debat dhe të votojë.

* * *

Për herë të parë çështja e deklarimit të pasurive dhe e interesave financiarë të deputeteve (kategoria e deputetëve ishte edhe me një sërë të zgjedhurish të tjerë në pushtetin vendor dhe nëpunësit e lartë të administratës publike) u rregullua me ligjin nr.7903, datë 8.3.1995. Ky ligj gjatë viteve në vazhdim u bë i pazbatueshëm në praktikë dhe format, mënyrat dhe strukturat që ai ngriti e provuan veten se ishin të papërshtatshme për të realizuar qëllimet e ligjit. Numri i madh i subjekteve që mbartnin detyrimin për deklarim,

should have been done much earlier. Lessons from the earlier law are reflected in the new one in the commendable effort to restrict the category of subjects that have to declare their assets, a category that includes members of parliament. Furthermore the law clearly stipulates the administrative structures that have the necessary competences necessary to implement oversight as well as sanctions for non compliance. The new law places Albanian in the category of countries where the declaration of assets is mandatory and open to the public. Despite a number of positive novelties it is too early to assess the degree to which such law will be implemented. However it is possible to provide some preliminary considerations. On the negative side the relationship between the Central Inspectorate and the Local Inspectorates appears problematic. The law stipulates that in every state owned enterprise that deals with public funds local inspectorates should be set up. However their relationship with the

paqartësitë e deklaramit të pasurisë dhe të interesave financiarë, ngritja e një komisioni miks me përfaqësues shtetërorë, që këtë detyrë e kishin me kohë të pjesshme, dhe për më tepër mungesa e kompetencës së verifikimit dhe e kontrollit nga ana e këtij komisioni të deklaramit të pasurisë dhe të interesave financiare të bërë nga subjektet mund të renditen si mangësitë themelore që sollën dështimin e zbatimit të atij ligji. Një rregullim i tillë gjysmak bëri që deklarimi i pasurive nga të zgjedhurit të mbetej ende një çështje e pazgjidhur dhe i vetmi sanksion, edhe sikur të ndërmerrej, ishte një gjobë me vlerë modeste, vetëm për mosparaqitje në afat të deklaramit.

Ndonëse me vonesë, ligjvënasi iu adresua kësaj çështjeje, i shtyrë edhe nga presioni i organizatave ndërkombëtare dhe i shoqërisë civile, me miratimin e ligjit të ri nr.9049, datë 10.4.2003. I ndërgjegjshëm për mangësitë e ligjit të vjetër të deklaramit të pasurive, në të shihet një përpjekje e lavdërueshme, për të ngushtuar rrethin e subjekteve që detyrohen të deklarojnë pasuritë dhe interesat financiarë (deputetët futen në këtë kategori), krijon struktura administrative, të cilat

Central Inspectorate is problematic for two reasons; first local inspectorates are set up without any criterion and second in many cases state agencies do not have resources to set them up professionally.

Finally, the Central Inspectorate as a monocratic institution elected by Parliament is a model that has not been tested anywhere else in Eastern or Western Europe.

Institutionalization of the dependence parliament – groups of interest: Hearing sessions of the parliamentary committees

There are no defined rules in any of Western Countries about the rights and duties of the lobbyists in their relations with MPs, similar with the Federal Act for Regulation of Lobbyism presented in USA on 1946. The list of lobbyists in the German Bundestag does not contain any information regarding the activities of lobbyists. In principal that is as address list, but still some organizations like syndicates and church, which plays an important role in the legislative process are not mentioned at all.

detyrimisht kanë edhe kompetencën e verifikimit dhe të kontrollit të deklarimit të bërë, si dhe paraqet sanksione në rast mospërbushjeje të rregullave ligjore të përcaktuara prej tij.

Me anë të këtij ligji Shqipëria hyn në rrethin e atyre vendeve, të cilët deklarimin e pasurisë dhe të interesave financiarë të të zgjedhurve e kanë të detyrueshëm me ligj dhe aksesin e publikut për t'u njohur me këto deklarime është i pakufizuar. Ndonëse të rejtat që sjell ligji i ri janë të dukshme, është ende herët të flitet nëse implementimi i tij është i suksesshëm ose jo për hir të kohës së shkurtër në veprim të tij. Gjithsesi, disa konsiderata paraprake edhe mund të jepen. Për shembull rezerva të mëdha paraqet suksesi i këtij ligji në raport me institucionet verifikuese që ai ngre si Inspektorati i Lartë dhe inspektoratet e ulta dhe marrëdhëniet që ato krijojnë mes tyre. Sipas ligjit, çdo ndërmarrje që ka në dispozicion dhe prokuron fonde publike duhet të ngrejë, me punonjësit që ka, inspektoritet e ulta, por në praktikë është vërejtur se marrëdhëniet e tyre me Inspektorin e Përgjithshëm dhe inspektorët janë problematike dhe kjo jo vetëm në kuadrin e krijimit të të parave vend e pa vend, por edhe në

The public hearing sessions organized by the parliamentary committees is therefore one of the ways to institutionalize the relationship between parliament and the groups of interests. The parliamentary committees do have the right to invite representatives of the groups of interests, organizations or representatives of the different social level, which are vulnerable to the passed new legislation. Some types can be sorted out from the parliamentary studies experience:

- Parliaments in which are developed rarely public hearings, normally with close doors, a typical case is the National Assembly in France where such sessions are extremely rare and when they happen they are not filed and are done with close doors. In Austria the hearing sessions have a greater frequency, but they are carried out with close doors.

- Parliaments where hearing sessions are developed with the groups of interest in an average level. In some cases in those categories their publicity is limited. Such

mjaftueshmërinë profesionale të punonjësve të inspektoratit të ulët në kryerjen e detyrës ligjore. Gjithashtu, edhe skema e ndërtimit të institucionit qendror dhe përgjegjës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive si një organ monokratik i zgjedhur nga Kuvendi, të paktën është një model që nuk e ka eksperimentuar asnjë vend i Europës Lindore dhe Perëndimore.

c)Institucionalizimi i ndërvarësisë parlament - grupe të interesit: Seancat dëgjimore të komisioneve të parlamentit

Në asnjë nga vendet e Europës Perëndimore nuk ekzistojnë rregulla të përcaktuara për të drejtat dhe detyrat e lobistëve në marrëdhëniet e tyre me deputetët, të ngjashme me Aktin Federal të Rregullimit të Lobimit të paraqitur në SHBA në vitin 1946. Edhe lista e lobistëve në Bundestagun Gjerman nuk përmban informacion për veprimtarinë e lobistëve. Në thelb ajo është një listë me adresa, por edhe në këtë aspekt disa organizata, si sindikatat ose kisha, e cila luan një rol të fuqishëm në procesin legjislativ, nuk përmenden fare.

Një mënyrë gjithsesi, me anë të të cilës marrëdhëniet mes parlamentit dhe grupeve të interesit janë institucionalizuar,

examples are Belgium, Italy, and Norway.

- The third category referees to countries where hearing sessions are a common event and are carried out with open doors. Such cases are for example Finland, Germany, Island, Sweden, and European Parliament of Holland. In Finland for example even the public hearing sessions are not carried out with open doors, they are filed and are reflected in media as parliamentary files.

* * *

Unfortunately at that point the Albanian Parliament is not close to any of the above-mentioned categories. Public hearing sessions are a rare element in the experience of the Albanian parliament. In cases when it happens, mostly they are transformed in reencountering arena of political idea than getting opinions from the social groups. The main problem of the Albanian reality is that not only they happen very rarely in practice, but also we still do not have a legal formalizing of the meaning and obligation to held them. In other

janë seancat dëgjimore publike që organizojnë komisionet e parlamentit. Komisionet e parlamentit kanë të drejtë të ftojnë përfaqësues të grupeve të interesit, organizata ose përfaqësues të shtresave shoqërore të cilët preken në rastet e miratimit të legjislacionit të ri ose për këshillime ose apo takime formale. Disa tipe mund të nxirren nga studimi e përvojave parlamentare:

- Parlamente në të cilat zhvillohen rrallë seanca dëgjimore dhe normalisht me dyer të mbyllura; rasti më tipik në këtë drejtim është ai i Asamblesë Kombëtare të Francës, ku seanca të tilla janë jashtëzakonisht të ralla, po dhe kur ndodhin, as nuk dokumentohen dhe bëhen me dyer të mbyllura. Në Austri seancat dëgjimore kanë një frekuencë më të madhe të zhvillimit të tyre, por ato bëhen me dyer të mbyllura.

- Parlamente ku zhvillohen në një nivel mesatar seancat dëgjimore me grupe të interesit. Në disa raste në këtë kategori edhe publiciteti i tyre është i kufizuar. Shembuj të vendeve të tillë janë Belgjika, Italia dhe Norvegjia.

- Kategoria e tretë është kategoria e vendeve në të cilat zhvillimi i seancave të tilla është një gjë e zakonshme dhe ato zhvillohen me dyer të hapura. Raste

words it is necessary to define in the Regulation of the Assembly a clear expression of the interdependence between the parliament and different society levels. On the other side either when the hearing sessions are held, their filing is truncated, and the public access to those files is missing and public information in this regard is also missing completely. Anyway sporadic cases of such practices even successful ones are held in the Assembly. Here we can mention the hearing session on passing the budget for 2004. Civil society and trade unions organized a public hearing session where they introduced their concerns for the education level in Albania. They put forward their request to increase the budget funding regarding the education sector, requests approved by the Parliamentary Committee of Economy and Finance in the plenary session of the Assembly.

CONCLUSIONS

The material presented above constitutes the first attempt to the

të tilla janë, për shembull, ai i Finlandës, Gjermanisë, Islandës, Suedisë, Hollandës, si dhe Parlamentit Europian. Në Finlandë ndonëse seancat nuk zhvillohen me dyer të hapura, ato dokumentohen dhe pasqyrohen në media si dokumente parlamentare.

* * *

Fatkeqësisht në këtë pikë Kuvendi i Shqipërisë nuk i afrohet asnjë prej kategorive të më sipërme. Seancat dëgjimore publike janë një element tepër i rrallë në përvojën parlamentare shqiptare dhe, në ato raste kur ato ndodhin, më tepër shndërrohen në arena dyluftimi idesh politike sesa në marrjen e mendimit dhe përçimin e intresave të grupeve shoqërore. E meta kryesore e realitetit shqiptar është se ato jo vetëm ndodhin rrallë në praktikë, por edhe se ende nuk kemi një formalizim juridik të kuptimit dhe detyrimit për mbajtjen e tyre. E thënë me fjalë të tjera, është e nevojshme dhe e domosdoshme që në Rregulloren e Kuvendit të gjejë shprehje të saktë dhe të qartë ky element ndërvarësie mes parlamentit dhe shtresave të ndryshme shoqërore. Nga ana tjetër, edhe kur seanca të tilla realizohen, dokumentimi i tyre është tepër i cunguar, aksesit i publikut në to

treatment of a new subject in the Albanian parliamentary life. Perhaps this is an accelerated step, which in the most extreme case, there are a lot of people thinking that discussing about lobbying in the conditions of a very hot actual political life and the poorest economy, is a luxury, either when it exist doesn't function. The experience of some Eastern countries shows that lobbying is a phenomenon that should not be neglected but treated, either legally. On the other hand, the Albanian approximation toward this phenomenon should be in synchronization with the European one as long as we are in the European contexts. The purpose remains that parliament should not be an autonomic actor, which formulates and accomplish policies and objectives in front of different social groups' interests, neither simply, reflecting specific social groups' interests. Through lobbying are ensured a procedural control in the influence that social groups have over the authority of legislators.

është i mangët dhe informimi i publikut ose është i cekët ose mungon fare. Sidoqoftë raste sporadike të praktikave të tilla madje edhe të suksesshme janë kryer në Kuvend. I tillë ishte rasti i miratimit të Buxhetit të vitit 2004 ku lëvizje të shoqërisë civile dhe sindikata arsimore realizuan një seancë dëgjimore në të cilën ato paraqitën shqetësimet e tyre për nivelin arsimor në Shqipëri dhe parashtruan kërkesat e tyre për rritjen e fondeve që Buxheti i Shtetit duhet t'i alokojë sektorit të arsimit, kërkesa të cilat u miratuan nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe më pas nga Kuvendi në seance plenare.

PËRFUNDIME

Materiali i sipërparaqitur përbën përpjekjen e parë për të trajtuar një temë të re të jetës parlamentare shqiptare. Ndoshta edhe kjo në vetvete përbën një hap të nxituar sepse, në rastin më të shkajshëm, besoj se nuk janë të paktë ata që mendojnë se në kushtet aktuale të jetës politike të nxehtë dhe një ekonomie më të varfër në Europë, të flasësh e të diskutosh për lobimin është luks i tepërt, sepse ai edhe mund të mosekzistojë apo edhe kur krijohet nuk funksionon. Është e natyrshme që

debate edhe për fakte të tilla do të ketë, por përvoja e disa vendeve lindore tregon se lobimi është një dukuri, e cila nuk duhet neglizhuar, por duhet trajtuar, madje edhe ligjërisht. Nga ana tjetër, përfaqësja shqiptare ndaj kësaj dukurie detyrimisht duhet të jetë në sinkron me atë europiane, përse kohë edhe realiteti mbetet europian. Qëllimi në vetvete, duke njohur dhe trajtuar lobimin, përfshirë edhe kontekstin shqiptar, mbetet që parlamenti të mos jetë një aktor autonom që formulon dhe realizon politika dhe qëllime përballë interesave të grupimeve të caktuara të shoqërisë, as edhe thjesht të reflektojë interesat e grupimeve të caktuara shoqërore. Më tepër se kaq, nëpërmjet lobimit sigurohet një kontroll procedural në ndikimin që kanë grupime shoqërore mbi autoritetin vendimmarrës legjislativ.

Blendi Kajsiu

Seanca dëgjimore Kombëtare e të rinjve - një model i suksesshëm

Seancat e dëgjimit janë një instrument i rëndësishëm për demokracinë. Ato kanë një qëllim të dyfishtë. Nga njëra anë ato përmirësojnë procesin e vendimmarrjes, duke u siguruar vendimmarrësve informacion nga të gjitha palët e interesuara. Nga ana tjetër ndihmojnë, duke e bërë procesin e vendimmarrjes të hapur dhe më transparent. Si rrjedhojë, kjo krijon një legjitimitet dhe pranim më të gjerë, duke ndihmuar në zbatimin e vendimeve dhe ligjeve. Shkurtimisht *seancat e dëgjimit* janë procedurë këshillimi, nga ku çdo grup dhe individ të interesuar, që variojnë nga autoritetet publike tek OJF, koalicionet, aleanca, institucione dhe organizata të tjera, japin një ndihmesë

The national youth public hearing: a successful model

Public Hearings are an important instrument of democracy. They serve a twofold purpose. On the one hand they improve the decision making process by supplying the decision makers with information from all the interested parties. On the other hand by doing so they also serve to make the decision making process more open and transparent. This in turn produces greater legitimacy and acceptance making it easier for decisions and law to be implemented. In short Public Hearings are a consultation procedure whereby any interested groups or individuals ranging from public authorities to NGO's, coalitions, alliances, other institutions and organizations, bring a transpar-

transparente për vendimmarrjen e politikave. Ata sigurojnë një bazë efektive e rigoroze për mbledhjen e një numri të konsiderueshëm opinionesh, këndvështrimesh të grupeve të interesuara ose të atyre të cilët ndikon çështja në debat.

Për këtë arsye Instituti Republikan Ndërkombëtar organizoi një Seancë Dëgjimore të Rinisë më 29 maj 2004 në hotel "Dajti" të Tiranës. Qëllimi kryesor i seancës ishte të bashkonte rininë dhe anëtarët e Kuvendit të Republikës, për të rritur ndikimin e tyre në procesin legjislativ dhe për të përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes së Kuvendit, duke marrë ndihmesë nga OJF-të rinore, organizatat, grupet e interesit dhe individët. Për këtë qëllim iu kërkua organizatave rinore të paraqitnin me shkrim dëshmi me problemet që ata pretendojnë se janë të rëndësishme, të cilat mund dhe duhet të adresohen nga vendimmarrësit. Organizatorëve iu paraqitën më shumë se 25 dëshmi, nga të cilat, për shkak të kufizimeve kohore, 13 u paraqitën verbalisht përpara panelit me anëtarët e Kuvendit.

ent contribution to policy decision-making. They provide a rigorous and effective framework for the collection of a significant number of opinions, viewpoints of the interest groups or which the debate issue has an impact.

It was for these reasons that the International Republican Institute organized a Youth Public Hearing on May 29th, 2004, at Dajti Hotel, Tirana. The main aim of the hearing was to bring together youth and Members of Parliament together so as to enhance the impact of the former on the legislative process and to improve the quality of decision making of the latter by receiving input from youth NGO-s, organizations, interest groups and individuals. To this end youth organizations were asked to submit written testimonies with problems they deem to be important and that can and should be addressed by the decision makers. More than 25 written testimonies were submitted to the organizers, of which, due to time limitations only 13 were presented verbally in front of the panels with the Members of Parliament.

U ndoqën një sërë hapash që çuan në arritjen e suksesshme të seancës dëgjimore të rinisë. Së pari, IRI kreu një vëzhgim kombëtar rinor në zonat urbane në Shqipëri, ku u identifikuan problemet kryesore të rinisë. Rezultatet e këtij vëzhgimi u shpërndanë vendimmarrësve dhe pjesëmarrësve të organizatave rinore. Vëzhgimi vendosi bazat e fazës parapërgatitore për seancën e hapur.

FAZA PËRGATITORE

Ligji nr. 9037, datë 27.3.2003 “Për ratifikimin e “Protokollit të katërt shtesë të Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe për Europën Juglindore””. Shtetet palë të Marrëveshjes për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe për Europën Juglindore (M.P.F.S.E.E.), duke rikonfirmuar angazhimin e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të përfshira në Marrëveshje dhe me vullnetin për të përmirësuar më tej këtë Marrëveshje për Forcat Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, për zgjerimin e iniciativës dhe për të arritur nivelet më të larta të ndëroperativitetit, duke përfshirë dispozita shtesë dhe duke rregulluar tekstet ekzistuese, procedurat dhe shkurtetat, me qëllim që ato të jenë në linjë me praktikën dhe terminologjinë e NATO-s, kanë rënë dakord dhe kanë miratuar Protokollin e Katërt Shtesë, i

Law no. 9037, dated 27 March 2003 “On the ratification of the ‘Fourth supplementary protocol of the Agreement on the Multinational Peacekeeping Force for South-eastern Europe’.” The states party to the Agreement on Multilateral Peacekeeping Forces for the South-eastern Europe (M.P.F.S.E.E.), by reconfirming their commitment to the aims and principles embodied in the Agreement and willing to further improve this Agreement on the Multilateral Peacekeeping Forces - in order to expand the initiative and to attain higher levels of interoperability, based on the supplementary provisions and by improving the existing texts, the procedures and the documents, in order to be in line with the practices and terminology of NATO - have accepted and improved the Fourth Supplementary Protocol, which has also been ratified by the Assembly of Albania in law no. 9037, dated 27 March 2003. The Fourth Supplementary Protocol has made amendments and supplements to Articles 1, 2, 3, 4, 7 of the Agreement, and to Annexes A, C, and E. Aside from the supplements and amendments,

cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9037, datë 27.3.2003. Nga Protokoli i Katërt Shtesë del se ai ka bërë shtesa e ndryshime në nenet 1, 2, 3, 4, 7 të Marrëveshjes, si dhe në Anekset A, C, dhe E. Përveç shtesave e ndryshimeve janë ndryshuar e zëvendësuar edhe shumë terma. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.6.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.29 të vitit 2003, në faqen 950. Ligjit i bashkëlidhet edhe Protokoli i Katërt Shtesë. Ligj nr.9038, datë 27.3.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm””. Marrëveshja e lidhur midis dy qeverive shpreh dëshirën e tyre për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore, si dhe për të siguruar një zbatim të efektshëm të dispozitave të legjilacionit të tyre kombëtar për lëvizjen e personave. Gjithashtu, merret angazhimi për parandalimin e migracionit të paligjshëm, duke respektuar të drejtat dhe garancitë ligjore në frymën e bashkëpunimit, si dhe mbi bazën e reciprocitetit. Në

several of its terms have been replaced and amended. The law has two articles and has entered into force on 22 June 2003. It is published in the Official Gazette no. 29, year 2003, p. 950. The Fourth Supplementary Protocol is attached to the law.

Law no.9038, dated 27 March 2003 “On the ratification of the ‘Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Croatia for the repatriation of persons with unlawful residence.’” The Agreement signed between the two governments voices their wish to develop friendly relations and to ensure an effective implementation of the provisions of their national legislation regarding the movement of persons. It is committed to the prevention of unlawful emigration and to respecting legal rights and guarantees in the spirit of cooperation and on the basis of reciprocity. The Agreement envisions the cases and the conditions for the repatriation of the citizens of the contracting parties, the instances of the repatriation of citizens from a third state,

Marrëveshje janë parashikuar rastet dhe kushtet e ripranimit të shtetasve të palëve kontraktuese, rastet e ripranimit të shtetasve të një vendi të tretë ose të personave pa shtetësi, procedurat e rasteve të tilla, si dhe detyrimet për plotësimin e një dokumentacioni të saktë për të dhënat vetjake të këtyre personave. Gjithashtu, në Marrëveshje janë parashikuar afatet kohore të cilat duhet të respektohen nga pala kontraktuese e kërkuar për t'iu përgjigjur kërkesave që i drejtohen asaj, si dhe mënyra e zgjidhjes së kalimit tranzit për shtetasit e një vendi të tretë të cilët janë larguar nga territori i palës kontraktuese, e cila kërkon tranzitim. Të dhënat vetjake që do të përdoren vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe mbrojtja e tyre do të sigurohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve kontraktuese. Është parashikuar, gjithashtu, edhe zgjidhja e problemeve të shpenzimeve për kthimin e personave të ripranuar, pra cila nga palët, sipas rastit, do të mbulohen prej tyre. Klauzolat e përgjithshme dhe përfundimtare të kësaj Marrëveshjeje

or of persons without nationality, the procedures for such cases and the obligations to fill in the accurate documentation regarding the personal data of these persons. The Agreement also envisions the deadlines that should be respected by the contracting parties in order to respond to the demands addressed to them, as well as the manner of the transit passage for the citizens of a third country, who have left the territory of the contracting party that demands the transit passage. The personal data will be used only for the purposes of the implementation of this Agreement and will be protected in conformity with the national legislation of the contracting parties. It also provides for the solution of the question of the expenses entailed for the repatriation of persons, that is, explains which of the parties is going to meet such expenses. The general and final clauses of this Agreement envision apart from others, that after the entry into force of this agreement, the ministries of public order and of interior of the contracting parties shall draft a protocol for its implementation. The law has two articles and has entered into

parashikojnë veç të tjerash, që pas hyrjes në fuqi të saj, ministritë e rendit publik dhe të brendshme të palëve kontraktues do të hartojnë një protokoll për zbatimin e saj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.29 të vitit 2003, në faqen 955. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.9039, datë 27.3.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8088, datë 21.3.1996 “Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”. Sipas ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, këto shoqëri janë bashkime vullnetare të personova fizikë ose juridikë, për kryerjen e veprimeve ekonomike në fusha të ndryshme. Me ligjin nr.9039, datë 27.3.2003 bëhen pesë shfuqizime, tetë ndryshime dhe nëntë shtesa në ligjin në fuqi. Kështu shpjegohet fjalja parë e nenit pesë, e cila parashikonte një afat 99-vjeçar për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, shfuqizohet një fjali në nenin 48 që ka të bëjë me mosprekjen e rezervave financiare dhe shfuqizohen tërësisht nenet 45, 46 dhe

force on 22 May 2003. It is published in the Official gazette no. 29, year 2003, p. 955. The Agreement is attached to the law.

Law no. 9039, dated 27 March 2003 “On some supplements and amendments to law no. 8088, dated 21 March 1996 ‘On joint companies’.” Under law no. 8088, dated 21 March 1996 “The joint companies,” such companies consist in the voluntary union of physical or juridical persons for the implementation of economic activities in various fields. Law no. 9039, dated 27 March 2003 abrogates five provisions, makes eight amendments and nine supplements to the law in force. It therefore explains the meaning of the first sentence of Article five, which envisions a 99 year deadline for the exercise of the activity of the company; revokes a sentence in Article 48, which says that financial reserves must not be touched, and repels altogether Articles 45, 46, and 47. The most important changes are made to Article 17, which deals with the loss of membership in the society and to Article 29, which speaks of the Supervisory

47. Ndryshimet më të rëndësishme bëhen në nenin 17 që trajton humbjen e cilësisë së anëtarit të shoqërisë, në nenin 29 që flet për Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë përcaktime më të qarta për këtë organ, për përbërjen e tij, për ndryshimin e anëtarëve, për llojin e vendimeve që merr ky Këshill, si dhe për kompetenca të tjera të Këshillit. Ndryshohet krejtësisht neni 39 që trajton kushtet e kthimit të pjesëve të kapitalit që i përket anëtarit që largohet nga shoqëria. Përsa u përket shtesave, më të rëndësishmet janë shtesat e nenit 12/1 që ka të bëjë me statusin e shoqërisë, për të cilin në ligjin në fuqi nuk ka asnjë shpjegim se çfarë duhet të përmbajë ky status. Neni 12/1 përmban 12 kriterë kryesore që duhet të përmbajë statuti. Shtesa të tjera kanë nenet 23 (Për të Drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme), 28 (ëër këshillin administrativ), 43 (fodi i rezervës për mbulimin e rreziqeve) etj. Ligji ka 20 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2003, në faqen 965.

Council, making clearer definitions about this body, its composition, the rotation of its members, the kinds of decisions taken by this Council, and the other powers that the Council has. Article 39, which deals with the conditions for the restitution of the shares of capital to the member who leaves the company, is entirely changed. With respect to the supplements, the most important ones are the supplements to Article 12/1, which deal with the status of the company, for which there is no stipulation at all in the law in force. Article 12/1 comprises the main criteria that should be contained in the statute. Other supplements are contained in Article 23 (On the right to the vote in the General Assembly), Article 28 (On the administrative council), and Article 43 (the contingency fund for the coverage of the risks) and others. The law has 20 articles and has entered into force on 25 May 2003. It is published in the Official Gazette, no. 30, year 2003, p. 965.

Law no. 9040, dated 27 March, 2003 “On some supplements to Law no. 7892, dated 21 December

Ligji nr. 9040, datë 27.3.2003 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, ndryshuar me ligjin nr. 8282, datë 21.1.1998. Në nenin 5 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, parashikohen lehtësirat tatimore që përfiton sponsorizuesi, për shumicën e sponsorizuar në fakt. Kështu, subjekteve që paguajnë tatim mbi fitimin, shuma e sponsorizuar u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 4 për qind të fitimit para tatimit, kurse subjekteve që paguajnë tatim mbi biznesin e vogël, shuma e sponsorizuar u zbritet deri në masën 1 për qind të të ardhurave të tatueshme. Me ligjin nr. 8282, datë 21.1.1998 u bë një shtesë në nenin 5 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”. Kështu, nenit 5 që kishte dy shkronja “a” dhe “b”, iu shtua shkronja “c”, e cila ka këtë përmbajtje: “Subjekteve, personave fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin sipas ligjit nr.7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit u njihet si shpenzim i fitueshëm deri në masën 10 për qind të fitimit

1994 ‘On sponsorships’ amended in law no. 8282, dated 21 January 1998. Article 5 of Law no. 7892, dated 21 December 1994 “On sponsorships,” envisions tax facilities for the sponsor, for the major part of the sponsorship. Thus, the entities that pay income tax are recognized the sponsored contribution as a deductible expense up to 4 percent of the income tax, while for the subjects that pay small business taxes, their sponsorship contributions are deducted up to the amount of 1 percent of the taxable income. Law no. 8282, dated 21 January provides for a supplement to Article 5 of law no. 7892, dated 21 December 1994 “On sponsorships”. Thus to Article 5, which had two letters, “a” and “b,” was added letter “c” with the following content: “The entities, the physical and juridical persons who pay income taxes under law no. 7677, dated 3 March 1003 ‘On income tax,’ shall be recognized the amount sponsored for the media publishers as a profitable expense up to the amount of 10 percent of the profit before the taxes. In the recent law, that in law no. 9040, dated 27 March 2002, Article 5, letter “c” after the words

para tatimit. Me ligjin e fundit, pra me ligjin nr. 9040, datë 27.3.2002, në nenin 5, në shkronjën “c”, pas fjalëve “... shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit...” shtohen fjalët “...dhe botimet e veprat letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore, artistike e sportive”. Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Këshilli i Ministrave përcakton kërkesat dhe masat e sponsorizimit nga personat juridikë publikë.” Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30 të vitit 2003, në faqen 970.

Ligji nr. 9041, datë 27.3.2003 “Për një shtesë në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”. Në nenin 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” janë parashikuar rastet kur organet tatimore lejojnë transaksione pa pagimin e akcizës, si dhe kur ato bëjnë rimbursimin e akcizës së paguar. Këto përjashtime kushtëzohen nga disa fakte që duhen provuar. Në pikën 2 të nenit të lartpërmendur thuhet: “Në zbatim të këtij ligji organet tatimore

“...the amount sponsored for the media publishers...” shall be added the words “...and for the publication of the literary, scientific, encyclopedic publications, as well as for cultural, artistic, and sports activities.” At the end of Article 5, a paragraph with the following content shall be added, “The Council of Ministers shall determine the demands and the amount of sponsorships by means of public juridical persons.” The law has two articles and has entered into force on 25 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 30, year 2003, p. 970.

Law no. 9041, dated 27 March 2003, “On a supplement to law no. 8976, dated 12 December 2002, ‘On excises’. Article 19 of Law no. 8976 “On excises” envisions those cases when the tax organs shall allow transactions for the payment of excises, as well as when they reimburse the paid excise. The exemptions depend on some factors that must be proven. Point 2 of the abovementioned Article says, “In implementation of this law, the tax authorities shall reimburse the paid excise when it is proven that: a)the

bëjnë rimbursimin e akcizës së paguar, kur provohet se: a) mallrat e akcizës janë subjekt i një procesi të miratuar; b) mallrat e akcizës eksportohen. Sipas ligjit nr. 9041, datë 27.3.2003 shtesa bëhet në pikën 2 të nenit 19, e konkretisht, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje: “Për gazoilin e shitur për anijet e peshkimit në sasi të, kushtet dhe personat e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003 dhe i fillon efektet e tij ligjore më 1.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30 të vitit 2003, në faqen 970.

Ligji nr. 9042, datë 3.4.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit “Furnizuesi me ujë, Kavaja II, Manskuria” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)”. Sipas kësaj marrëveshjeje Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) do t’i japë Republikës së Shqipërisë një hua prej 2.045.167 Euro dhe një kontribut financiar në shumën 1.533.875.

excise goods are subject to an approved process; b)The excise goods are exported. Under law no. 9041, dated 27 March 2003, to point 2 of Article 19, and more specifically after letter “b,” shall be added letter “c” with the following content: “For the gas oil sold to fishing vessels in amount, under the conditions, and to the persons determined in the decision of the Council of Ministers.” The law has two articles and has entered into force on 25 May 2003 and will legal effect on 1 July 2003. It is published in the Official Gazette no. 30, year 2003, p.970.

Law no. 9042, dated 3 April 2003 “On the ratification of the ‘Loan and financing Agreement, the project “Water supply for Kavaje, II, Manskuria” between the Republic of Albania and the German Bank for Reconstruction and Development (KfW).” Under this Agreement, the German Bank for Reconstruction and Development, (KfW) shall grant the Republic of Albania a loan worth 2.045.167 euros and a financial contribution worth 1.533.875 euros. The Bank of Albania (the

Republika e Shqipërisë (Huamarrësi) do të kalojë të gjithë shumën tek Agjencia Zbatuese, e cila do ta përdorë huanë vetëm për financimin e nxjerrjes, transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për zonat e ujësjellësit të Kavajës, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës dhe kontributin financiar vetëm për mbështetjen institucionale që shoqëron këtë proces, së pari, për të mbuluar koston e shërbimit të huaj. Marrëveshja parashikon masën e interesit, si dhe kohën e pagimit të huasë. Kështu, kësti i parë do të paguhet më 30 dhjetor 2012 dhe kësti i fundit më 30 qershor 2042, duke qenë për të gjithë kohën këstet e barabarta në masën 34.000, duke paguar dy këste në vit. Marrëveshja do të udhëhiqet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Në rast paqartësie ose dyshimi në lidhje me interpretimin e marrëveshjes, do të mbizotërojnë teksti në gjuhën gjermane. Të gjitha konfliktet që mund të vijnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe ato mbi vlefshmërinë e saj dhe të Marrëveshjes së Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhet miqësisht ndërmjet

Borrower) shall transfer the whole amount to the Implementation Agency, which shall use the loan only to fund the extraction, transport, and distribution of the potable water in the zones of Kavaje water pipeline, as well as for the respective consultancy services, while the financial contribution may be used only to ensure the institutional support that will be needed in the course of this process, and first and foremost to cover the cost of foreign services. The Agreement envisions the interest rate, and the deadlines for the repayment of the loan. Thus the first installment will be paid on 30 December 2012 and the last installment on 30 June 2042, and all installments shall be equal to 34.000 euros and will be paid twice a year. The Agreement shall be guided by the legislation of the Federal Republic of Germany. In cases of confusion or uncertainties regarding the interpretation of the Agreement, the text in German language shall have priority. All the disputes that may arise from the implementation of this Agreement, as well as those regarding its validity and that of the Arbitration Agreement, which may not be resolved in a friendly

palëve kontraktuese, do t'u nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim Marrëveshja e Arbitrazhit parashikon ngritjen e një gjyqi arbitrazhi. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30 të vitit 2003, në faqen 971. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë dhe Marrëveshja e Arbitrazhit.

Ligj nr.9043, datë 3.4.2003 ‘Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit ‘Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme, komponentët Berat dhe Kuçovë’, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)’”. Në bazë të një marrëveshjeje që pritet të përfundojë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për bashkëpunim financiar (marrëveshja qeveritare), kjo Marrëveshje lidhet midis Republikës së Shqipërisë si huamarëse,

manner between the contracting parties, shall be subject to the arbitration procedures in conformity with the Arbitration Agreement, which is a component part of this Agreement. For this purpose, the Arbitration Agreement envisions the establishment of an arbitration court. The law has two articles and has entered into force on 25 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 30, year 2003, p.971. The Loan Agreement and the Arbitration Agreement shall be attached to the law.

Law no. 9043, dated 3 April 2003 ‘On the ratification of the ‘Loan Agreement, the financing and the project for ‘Water supply of Central Albania, Berat and Kucove component’ between the Republic of Albania and the German Bank for Reconstruction and Development (KfW)’.” Under this Agreement, which is expected to be concluded between the Government of the Federal Republic of Germany and the Government of the Republic of Albania on financial cooperation (government agreement), this Agree-

e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW). KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 6 646 794 Euro, të cilën Huamarrësi do t'ia kalojë Agjencisë zbatuese (Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime Berat dhe Kuçovë për financimin e nxjerrjes, të transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për Beratin dhe Kuçovën, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës, kryesisht për të mbuluar koston e shkëmbimit. Gjithashtu, sipas Marrëveshjes, Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese e projektit nuk mund të caktojnë, transportojnë, garantojnë ose hipotekojnë një të drejtë të tyre të përcaktuar nga kjo Marrëveshje. Theksohet, gjithashtu, se kjo e fundit do të udhëhiqet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë dhe, në rast dyshimi, në lidhje me interpretimin e Marrëveshjes do të mbizotërojë teksti në gjuhën gjermane. Është parashikuar që të gjitha konfliktet që mund të lindin, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht nga palët kontraktuese do të zgjidhen përfundimisht vetëm nga një gjyq

ment shall be signed between the Republic of Albania, as the Borrower, represented by the Ministry of Finance, and the German Bank for Reconstruction and Development (KfW). The KfW shall grant the Borrower a loan worth 6.646 794 euros, which the Borrower shall transfer to the Implementation Agency (Water pipeline and Sewage enterprise in Berat and Kuçove) for financing the extracting and distribution of the potable water in Berat and Kuçove, as well as for the relevant consultancy services, mainly to cover the exchange cost. Under the Agreement, the Borrower and the implementation agency of the project may not decide, transfer, guarantee or mortgage any of their rights laid down in this Agreement. It is also stressed that the latter shall be guided by the legislation of the Federal Republic of Germany and in cases of uncertainties; the German language shall have priority regarding the interpretation of the Agreement. It has been likewise envisioned that all the disputes that may arise, which may not be resolved in a friendly manner by the contracting parties, shall be ultimately settled by an arbitration court with the

arbitrazhi, ku do të jenë palë Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese nga njëra anë dhe KfW-ja nga ana tjetër. Huaja do të fillojë të paguhet duke filluar nga 30 dhjetori 2012, nga dy këste në vit me nga 111 000 Euro çdo këst, dhe do të përfundojë më 30 qershor 2042. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2003, në faqen 981. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë dhe Marrëveshja e Arbitrazhit.

Ligj nr.9044, datë 3.4.2003 ‘Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së huasë, të financimit dhe të projektit ‘Furnizimi me ujë i Shqipërisë së Mesme, komponenti Lushnjë’, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)’. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në bazë të një marrëveshjeje që do të lidhin, kanë rënë dakord që Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) t’i japë Huamarrësit, (Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e

parties being, the Borrower and the implementation agency on the one hand, and the KfW on the other. The loan shall be repaid twice a year beginning from 30 December 2012, with installments of 111,000 euros, and will conclude on 30 June 2042. The law has two articles and has entered into force on 25 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 30, year 2003, p.981. The loan Agreement and the Arbitration Agreement shall be attached to the law.

Law no. 9044, dated 3 April 2003 ‘On the ratification of the loan Agreement, the financing, and the project of ‘Water supply of Central Albania, Lushnje component’ between the Republic of Albania and the German Bank for Reconstruction and Development (KfW)’. The Government of the Federal Republic of Germany and the Government of the Republic of Albania, under the Agreement that they shall sign, have agreed that the German Bank for Reconstruction and Development (KfW) shall grant the Borrower (The Republic of Albania, represented by the

Financave) një hua në shumën 4 601 629 Euro dhe një kontribut financiar në shumën 370 000 Euro (masa trajnuese). Sipas Marrëveshjes, Huamarrësi do ta kalojë huanë tek Agjencia zbatuese që është Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve Lushnjë në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje. Huaja do të përdoret vetëm për financimin e nxjerrjes, të transportimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm për zonën e ujësjiellësit të Lushnjës, si dhe për shërbimet përkatëse të konsulencës, kurse kontributi financiar do të përdoret për mbështetjen institucionale që shoqëron këtë proces, së pari për të mbuluar kostot e shkëmbimit të huaj ("Projekti"). Huaja jepet me një interes 0.75 për qind në vit dhe do të fillojë të paguhet duket filluar nga 30 dhjetori 2012. Çdo vit do të paguhet nga dy këste (në qershor e dhjetor) me një vlerë 76 000 Euro çdo kësht dhe pagesa e huasë do të përfundojë më 30 qershor 2042. Marrëveshja parashikon, gjithashtu, edhe pezullimin e disbursimeve dhe pagesat e parakohshme, vlerfshëmërinë e huasë, marrëveshjet për projekte etj. Të gjitha konfliktet në lidhje me

Ministry of Finance) a loan worth 4.601.629 euros and a financial contribution worth 370.000 euros (training share). Under this Agreement, the Borrower shall transfer the loan to the implementation Agency, which is the Water pipeline and Sewage enterprise in Lushnje, under a special loan agreement. The loan shall be used only to finance the extraction, transportation and distribution of the potable water for the zone of Lushnje water pipeline, and for the relevant consultancy services, while the financial contribution shall be used for the institutional support needed in the course of the process, and first and foremost to cover the costs of foreign exchange ("Project"). The loan shall be granted at a 0.75 interest rate a year and will begin repayment as of 30 December 2012. Every year, two installments shall be paid (in June and December) with a value of 76,000 euros for each installment and the loan repayment shall conclude on 30 June 2042. The Agreement also provides for the suspension of the disbursements, early payments, the validity of the loan, the agreements for the projects, and so on. All the disputes linked with the Loan

Marrëveshjen për hua, financim dhe projekt dhe në lidhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht nga palët kontraktuese, do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjyq arbitrazhi, ku palë do të jenë Huamarrësi dhe Agjencia zbatuese nga njëra anë dhe KfW - janë nga ana tjetër. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2003, në faqen 990. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë dhe Marrëveshja e Arbitrazhit.

Ligj nr.9045, datë 3.4.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit të ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH sh.a. dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar””. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë zotimet e ndërsjella të të dy palëve për një zbatim të saktë të Programit, me një vëmendje të veçantë të mënyrat e vlerësimit dhe lidhjes së kontratave, si dhe për

Agreement, the financing, the project, and the Arbitration Agreement, which may not be resolved in a friendly fashion by the contracting parties, shall be finally settled only by an arbitration court, where the parties shall be the Borrower and the implementation Agency on the one hand, and the KfW on the other. The law has two articles and has entered into force on 25 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 30, year 2003, p. 990. The Loan Agreement and the Arbitration Agreement shall be attached to the law.

Law no. 9045 dated 3 April 2003, “On the ratification of the Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Government of Italy for the implementation of the program of technical and management restructuring of KESH shareholder company and the strengthening of the Albanian electric system.” The purpose of this Agreement is to regulate the reciprocal commitments of both parties for an accurate implementation of the Program, with special focus on the ways of assessment and signing of

menaxhimin e përgjegjshmërinë në shpenzimin e fondeve të kredisë ndihmë dhe dhuratë. Objektivat e Programit janë që nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit dhe të vazhdimësisë së shërbimit elektrik, të përmirësojë standardin e jetës së popullit dhe të rrisë mundësinë e furnizimit me energji elektrike për sistemin prodhues për përkrahjen e zhvillimit të biznesit dhe rritjen e investimeve private. Marrëveshja përmban përshkrimin e Programit në mënyrë të detajuar, tregon institucionet e përfshira në realizimin e Programit, burimet financiare dhe mënyrat e përdorimit të kredisë ndihmë, mbikqyrjen e Programit, detyrimet e Qeverisë Italiane e të Qeverisë Shqiptare, mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Pjesë e Marrëveshjes janë edhe shtatë lidhjet që përmbajnë: Përmbledhjen e Programit, kushtet e realizimit, burimet financiare, mbikqyrjen dhe treguesit, njësinë e menaxhimit të projektit dhe formalitetet që duhen respektuar për ekzekutimin e menaxhimin e kredisë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare

the contracts, as well as on governing the responsibility for the expenditures of the credit funds given in the form of assistance and as donation. The objectives of the program are that through enhancement of efficiency and ensuring the continuity of electric supply and service to improve the living standards of the people, to enhance the possibility of electric supply for the entire production system, and to promote business development and growth of private investments. The Agreement contains a detailed description of the program, defining the institutions involved in the implementation of the program, the financial sources and the ways of the use of the credit aim, the supervision of the program, the obligations of the Italian and Albanian Governments, and the manner for the resolution of the disputes and so on. Part of this Agreement are also seven links that contain the Program Summary, the Terms of the Realization, the financial resources, the supervision and indicators, the project management unit, and the formalities that must be respected for the execution and management of the credit. The law has

nr.33 të vitit 2003, në faqen 1065. Ligjit i bashkëlidhen Marrëveshje dhe shtatë Lidhjet.

Ligj nr.9046, datë 3.4.2003 ‘Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për ndërtimin e godinës së komandës dhe të mjediseve të akomodimit të personelit, si dhe thellimin e kanalit hyrës dhe të basenit të bazës detare të Bishtit të Palës’.” Kjo Marrëveshje ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në lidhje me fillimin dhe përfundimin e ndërtimit të komandës dhe të mjediseve të akomodimit të Bazës Detare të Bishtit të Palës, si dhe thellimin e kanalit hyrës e të basenit të ankorimit të bazës detare të lartpërmendur, me shpenzimet e palës greke. Marrëveshja përmban, gjithashtu, statusin e aktiviteteve dhe të personelit të palës greke në Shqipëri, përgjegjësitë e kësaj pale dhe të palës shqiptare, përgatitjen, studimin dhe

two articles and has entered into force on 31 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 33, year 2003, and p. 1065. The Agreement and the seven links are attached to the law.

Law no.9046, dated 3 April 2003 ‘On the ratification of the Agreement between the Ministry of Defense of the Republic of Albania and the Ministry of National Defense of the Republic of Greece for building the command facility and other facilities for the accommodation of personnel, and for deepening the entry channel and the basin of the naval base in Bishti i Palles’.” This Agreement aims at determining the procedures and the liabilities of both parties regarding the beginning and the conclusion of the work for building the command and accommodation facilities in Bishti i Palles, as well as for the deepening the entry channel and the basin of anchor in the abovementioned naval base with the expenses of the Greek party. The Agreement also provides for the status of the activities and the personnel of the Greek side in Albania, the

miratimin e projekteve, grafikun e punimeve etj. Buxheti total për të gjitha këto punime do të jetë 5.5 milionë Euro, por shuma e saktë e vlerës së preventivit do të përcaktohet pas përfundimit të studimeve përkatëse. Një vend i veçantë në Marrëveshje i kushtohet detyrimit të të dy palëve në lidhje me përdorimin dhe ruajtjen e pajisjeve dhe të mjedisve. Detyrime janë vendosur edhe për mbrojtjen e çdo informacioni lidhur me takimet dypalëshe, duke mos ia dhënë palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të palës që i disponon këto informacione. Marrëveshja është nënshkruar në Tiranë më 30.2.2002 dhe do të jetë në fuqi për një periudhë kohore prej 5 vjetësh. Rinovimi bëhet automatikisht për një vit, në qoftë se palët nuk vendosin ndryshe. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.7.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.57 të vitit 2003, në faqen 2417. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.9047, datë 10.7.2003
“Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj

responsibilities of this side and the Albanian side, the training, the study and the approval of the projects, the graph of work and others. The total budget for all these works is going to be 5.5 million euros, but the accurate amount of the cost estimate value will be determined after the conclusion of the respective studies. A special place in the Agreement is devoted to the obligation of both parties with respect to the use and protection of the equipment and the environment. The obligations cover also the protection of any information linked with mutual meetings, which should not be made available to third parties without the prior approval in writing of the party that has the information. The Agreement was signed in Tirana on 30 February 2002 and is going to be in force for a time period of five years. The renewal of this agreement shall be made annually by default, unless agreed otherwise by the parties. The law has two articles and has entered into force on 29 July 2003. It is published in the Official Gazette no. 57, year 2003, p. 2417. The Agreement is attached to the law.

përcakton rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak. Në ligj përcaktohen llojet e shërbimit ushtarak, formula e betimit dhe mënyra e zgjidhjes së problemit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak për shtetasit me dy shtetësi. Në Kreun II “Shërbimi i detyrueshëm ushtarak” përcaktohen llojet e këtij shërbimi, mosha e kryerjes së shërbimit, kohëzgjatja, kriteret e mosnjohjes e të mosthirrjes në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ, shtyrja e afatit të kryerjes së shërbimit, lirimi para kohe, të drejtat e shtetasit në shërbimin ushtarak aktiv ose alternativ, përjashtimi nga shërbimi ushtarak në rezervë etj. Kreu III përmban detyrimet e organeve shtetërore, të subjekteve private e të shtetasve për shërbimin ushtarak dhe mobilizimin dhe trajton përgjegjësinë e qendrës së rekrutim-mobilizimit, mënyrën e funksionimit të komisioneve mjekësore të kontrollit të aftësive për shërbimin ushtarak, marrjen e shtetasve në

Law no. 9047, dated 10 July 2003 “On the military service in the Republic of Albania.”

This law defines the rules governing the military service in the Republic of Albania, the rights and the responsibilities of the citizens, the state bodies, and the private subjects regarding the drafting and the military service. The law lays down the kinds of military service, the formula of the oath and the way to resolve the question of military service for the citizens with dual nationality. Chapter II “Compulsory military service” determines the kinds of the service, the age for doing the military service, the duration, the criteria for the non-recognition and non-conscription in the compulsory active and alternative military service, the postponement of the deadline for doing the military service, the early discharge from the army, and the rights of the citizens during active or alternative military service. Chapter III contains the obligations of the state bodies, the private subjects and the citizens for military service and deals with the responsibility of the center for recruitment and drafting, the manner of functioning of the medical commissions on checking

evidencë, heqjen nga kjo evidencë, detyrimet në rast mobilizimi të shtetasve, detyrimet e njësisë së qeverisjes vendore, të institucioneve arsimore, të drejtësisë e të shëndetësisë. Po ashtu, në këtë Kre flitet për mobilizimin ushtarak në kohë paqe ose në kohë lufte dhe detyrimet e shtetasve, duke parashikuar, gjithashtu, edhe kundërvajtjet administrative. Shlyerja e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativat me pagesë, parashikohet të zbatohet deri më 31 dhjetor 2010. Ligji ka 45 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.8.2003. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji janë bërë disa shfuqizime në ligjin nr.7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë” dhe konkretisht nenet 1, 2, 3, 5 deri në 27 dhe 33 deri në 49. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr.64 të vitit 2003, në faqen 2845.

Ligji nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe objekt i tij janë vlerat e

the health condition and ability to carry out military service, the registration of the citizens, the removal from this registry, the obligations in case of need to draft citizens in the army, the obligations of the local authorities and of education judicial, and health institutions. Likewise, this Chapter talks about the military drafting in time of peace or in time of war and the obligations of the citizens, providing also for administrative offences. Payment for compulsory active and alternative military service is envisioned to be implemented up to 31 December 2010. The law has 45 articles and has entered into force on 19 August 2003. With the coming into effect of this law, some articles have been abrogated in law no. 7978, dated 26 July 1995 “On the Armed Forces of the Republic of Albania” and in real terms in Articles 1,2,3,5 up to 27 and from Articles 33 to 49. The law has been published in the Official Gazette no. 64, year 2003, p. 2845.

Law no.9048, dated 7 April 2003 “On cultural heritage” This law aims at proclaiming and protecting the cultural heritage in the territory of the Republic

trashëgimisë kulturore, parashikimi i rregullave për mbrojtjen e saj dhe detyrat e përgjegjësitetë e organeve që veprojnë në këtë fushë. Sipas ligjit, trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare. Në ligj jepen në mënyrë të detajuar se cilat janë objekte të trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe cilat janë objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, si dhe cilat janë vlera jomateriale të kësaj pasurie dhe caktohen organet përkatese për përcaktimin e llojit të këtyre vlerave, pronë e personave fizikë ose juridikë. Këto objekte, në mënyrë të detyrueshme duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore, si fillimisht, ashtu edhe kur ndryshohet pronësia e tyre. Një vend i veçantë i kushtohet objekteve të trashëgimisë kulturore me vlera të veçanta kombëtare unikale, mbrojtjes së tyre në mjedisë të përshtatshme, shumëfishimit ose riprodhimit etj. Objekte të tilla (me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale), kur e kërkon interesi publik, mund të shpronësohen sipas ligjit në fuqi për shpronësimet.

of Albania and its object are the values of cultural heritage, the provision of rules for its protection and the duties and responsibilities of the bodies that operate in this field. Under this law, the cultural heritage is composed of material and non material values, which are part of the national patrimony. The law makes a detailed description of those facilities that are part of solid cultural heritage and of those that are part of liquid cultural heritage, as well as which are the non-material values of this heritage. It also provides for the relevant bodies responsible for determining the classification of these values, property of the physical or juridical persons. These objects should necessarily be registered with the National Center of Inventory of Cultural Assets, both initially and when their ownership is changed. A special place in the law is devoted to objects of cultural heritage, with special and unique national values, their protection in suitable environment, the copying or reproduction and so on. When it is in the public interest, such objects (with special national and unique values) may be expropriated under the law in force on expropriations. The res-

Restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore bëhet nga institucionet shtetërore të specializuara dhe nga persona të licensuar për këtë qëllim, pasi të jetë dhënë miratimi nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Përveç kësaj lëvizjeje, një vend i caktuar i objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, pronë shtetërore, me vlera kombëtare unike, për restaurim, studim, ekspozim etj. bëhet me lejen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ligji përcakton se cilat janë monumentet e kategorisë së parë e të dytë, cilat quhen qytet-muze, zonamuzeale, qendra historike etj., si dhe favoret e mbrojtjen që kanë këto. Ky ligj ka 56 nene, ka hyrë në fuqi më 1.6.2003 dhe ka shfuqizuar ligjin nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.33 të vitit 2003, në faqen 1086.

Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Me këtë ligj

restoration of objects of cultural heritage shall be done by the specialized state institutions and by licensed persons after the approval of the National Council of restorations. Aside from this, a particular sight may become part of solid cultural heritage and state property with unique national values, and can be restored, studied and exhibited only with the permission of the Ministry of Cultural, Youth and Sports. The law lays down the first category monuments, the second category monuments, the criteria for becoming a museum city, historic sight and so on, as well as the benefits of protection they shall enjoy. The Law has 56 articles and has entered into force on 1 June 2003 after abrogating law no. 7867 dated 12 October 1994 “on the protection of movable and immovable cultural assets.” It is published in the Official Gazette, no 33, year 2003, p. 1086.

Law no. 9049, dated 10 April 2003 “On the disclosure and control of assets, the financial obligations of the elected officials and some public servants” This law defines the rules for the disclose and

përcaktohen rregulla për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta. Në ligj janë përcaktuar në mënyrë taksative subjektet që mbartin detyrimin për deklarim në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe në Inspektoratin e Ulët. Të gjithë këto subjekte duhet që brenda datës 31 mars të çdo viti të kenë deklaruar burimet e krijimit të kësaj pasurie. Ligji ka parashikuar pasojat që vijnë nga refuzimi për deklarim të pasurisë, si dhe detyrimet në rastin e deklarimit të parë, të deklarimit me kërkesë, të deklarimit para fillimit të punës për herë të parë dhe të deklarimit pas largimit nga funksioni. Në kreun e dytë të ligjit trajtohen organet, struktura dhe kompetencat e Inspektorit të Përgjithshëm dhe të Inspektoratit të Ulët, përcaktohen kushtet për t'u zgjedhur në këto detyra, papajtueshmëritë me detyrën, mbarimin e mandatit, përbërjen e inspektorateve etj. Organizimi i deklarimit të pasurisë dhe kontrolli është kreu i tretë i ligjit dhe

control of assets, the legitimacy of the sources of their creation, the financial obligations for the elected officials, the public servants, their family members and the persons linked with them. The law expressly determines the subjects that are obliged to disclose their assets to the High Inspectorate of the Disclosure and Control of Assets, as well as to the Lower Inspectorate. All the subjects should within 31 March of each year have disclosed the sources of the creation of their assets. The law prescribes the consequences that come from the refusal to disclose the assets, as well as the obligations stemming from the first disclosure, the disclosure upon request, the disclosure prior to beginning the work for the first time and the disclosure following the departure from that function. Chapter two of the law deals with the bodies, the structure and the powers of the General Inspector and the Lower Inspector, the conditions for their election to these tasks, the incompatibility with these duties, the conclusion of their mandate, the composition of the inspectorates and so on. The organization of the disclosure and the control are treated in the

përmban mënyrën se si duhet të bëhet deklarimi, si nga personi i punësuar, ashtu edhe nga pjesëtarët e familjes, kur pasuria është e ndarë midis tyre. Gjithashtu, në këtë kre trajtohen edhe llojet e kontrollit, detyrimi për të dhënat, përmbajtja e tyre, korrigjimi i gabimeve, thirrja e ekspertëve, përgjegjësia për deklarimin e rremë etj. Gjithashtu, në këtë ligj janë parashikuar edhe kundërvajtjet administrative, si dhe procedura për vendosjen dhe ankimin ndaj tyre si dhe ekzekutimin e gjobave. Ligji ka 43 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31 të vitit 2003, në faqen 1005.

third chapter of the law, which lays down the manner of making the disclosure of the assets, both by the employed person and the members of his or her family, when the assets are divided among them. Furthermore, this chapter deals also with the sorts of control, the obligation to provide data, their content, the correction of mistakes, the summoning of the experts, the liabilities for false disclosure and so on. The law also envisions the administrative offences and the procedures for the decisions and the appeal of such decisions, as well as the execution of the fines. The law has 43 articles and has entered into force on 30 May 2003. It is published in the Official Gazette no. 31, year 2003, p. 1005.